Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 305/20
Datë/Datum. 24.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 305/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "LeoMed sh.p.k"-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Parteshit", me nr. të prok:658-20-1728-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Partesh, më datën: 12.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "LeoMed sh.p.k"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Parteshit", me nr. të prok:658-20-1728-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Partesh.

II.ANULOHET, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Parteshit", me nr. të prok:658-20-1728-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Partesh dhe nëse AK më tutje ka interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthej në Ritender duke bërë korrigjimet e dosjes së tenderit konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "LeoMed sh.p.k"-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "LeoMed sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 15.05.2020 me nr.305/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ofrimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe të tjera në Komunën e Parteshit", me nr. të prok:658-20-1728-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Partesh, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 27, 28 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas analizimit të pretendimeve ankimorë sipas ankesës nr.305/20, dhe njoftimit për kontratë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues vlerëson se të gjitha pretendimet ankimorë të OE ankues janë të bazuara.

AK-KK Partesh me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit, për pozicionet 1 dhe 2 nuk ka qartësuar shërbimet a do të kryhen në objekte të QKMF apo në shtëpi të pacientit, ndërsa rubrika te çmimi kërkuar shënon vetëm për vizitë. Po ashtu kërkesa e AK-së që kompanitë të jenë të licencuara për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe kërkesa të kenë tri kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit 880,000€, vlerësojmë se është kërkesë diskriminuese e cila do të ngushtoj konkurrencën, ndërsa lidhur me këtë kërkesë ashtu siç ka propozuar OE ankues mund të kërkohet licenca e mjekut ose licenca infermierit.

Vlen të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit AK njëkohësisht ka kërkuar shërbime mjekësore,

shërbime arsimore, shërbime të transportit, shërbime administrative. Siç mund të shihet se gjitha këto shërbime janë të natyrave të ndryshme, për të cilat mendojmë se duhet të ndahen në LOTE në mënyrë që të ketë mundësi të pjesëmarrjes më të gjerë të OE-ve. Bazua në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë AK ka bërës shkelje të nenit 7, 27 dhe 28 të LPP-së dhe se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, si dhe rekomandojnë që të anulohet njoftimi për kontratë i AK-se, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthej në Ritender duke bërë korrigjimet e dosjes së tenderit konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë:02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër Njoftimit për kontratë (gjate fazës se ofertimit).

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se AK-KK Partesh me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit, për pozicionet 1 dhe 2 nuk ka qartësuar shërbimet a do të kryhen në objekte të QKMF apo në shtëpi të pacientit, ndërsa rubrika te çmimi kërkuar shënon vetëm për vizitë. Po ashtu kërkesa e AK-së që kompanitë të jenë të licencuara për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe kërkesa të kenë tri kontrata të

natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit 880,000€, andaj konstatojmë se është kërkesë diskriminuese e cila do të ngushtoj konkurrencën, ndërsa lidhur me këtë kërkesë ashtu siç ka propozuar OE ankues mund të kërkohet licenca e mjekut ose licenca infermierit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron, se për këtë aktivitet të prokurimit AK njëkohësisht ka kërkuar shërbime mjekësore, shërbime arsimore, shërbime të transportit, shërbime administrative. Siç mund të shihet te gjitha këto shërbime janë të natyrave të ndryshme, për të cilat konstatojmë se duhet të ndahen në LOTE në mënyrë që të ketë mundësi të pjesëmarrjes më të gjerë të OE-ve.

Paneli shqyrtues duke u bazua në te cekurat si me lart vjen ne përfundim se AK për aktivitetin e prokurimit ne fjale ka përgatitur dosjen e tenderit ne kundërshtim me nenin 7, 27 dhe 28 të LPP-së dhe se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara, andaj konstatojmë se aktiviteti i prokurimit ne fjale duhet te anulohet, nëse AK ka interes qe këtë aktivitet te prokurimit ta zhvilloj edhe me tutje, te njëjtin aktivitet mund ta Ri tenderoi duke bërë korrigjimet e dosjes së tenderit konform dispozitave të LPP-së si dhe rekomandimeve te dhëna nga ana e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi duke e aprovuar ankesën e ankuesit si te bazuar dhe duke e anuluar aktivitetin e prokurimit ne fjalë.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Partesh

1x1 OE -"LeoMed sh.p.k"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.